



Në bazë të nenit 19 të Ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës Nr. 2004/7, nenit 27 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës, Kryetari i OEK shpallë këtë:

**FTESË PUBLIKE PËR SHËRBIME KONSULENCE PËR HARTIMIN DHE KRIJIMIN
E NJË KORNIZE TË MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT (M&V) PËR ARSIMIN
DUAL**

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), përmes Qendrës për Arsimin Dual (QAD), në kuadër të projektit “Shkathtësitë për punësim të qëndrueshëm në Kosovë”, të financuar nga Qeveria e Luksemburgut dhe zbatuar nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor, ftonë konsulentë të kualifikuar dhe kompani konsulence të dorëzojnë oferta për shërbime konsulence lidhur me hartimin dhe krijimin e një sistemi të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V) për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Dual (DUAL VET).

Informata të përgjithshme

OEK ka një rol gjithnjë e më të rëndësishëm sistemik në mbështetjen dhe koordinimin e zbatimit të Arsimit Dual në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, (MASH), shkollat profesionale dhe sektorin privat.

Për të forcuar implementim e bazuar në evidencë, monitorimin, raportimin dhe të nxëniti institucional, OEK synon të krijojë një kornizë gjithëpërfshirëse të Monitorimit dhe Vlerësimit (M&V) për aktivitetet e Arsimit Dual.

Ky angazhim synon të mbështesë zhvillimin e indikatorëve të standardizuar, metodologjive të raportimit, mjeteve për mbledhjen e të dhënave, rrjedhave institucionale të punës dhe mekanizmave analitikë të raportimit.

Objektivi i angazhimit

Objektivi i kësaj konsulence është hartimi dhe operacionalizimi i një kornize gjithëpërfshirëse të M&V për programin e Arsimit Dual të zbatuar nga OEK.

Angazhimi do të mbështesë:

- krijimin e një kornize funksionale të M&V-së;
- zhvillimin e mjeteve të standardizuara për monitorim dhe raportim;
- forcimin e kapaciteteve institucionale brenda OEK-së;
- përmirësimin e raportimit dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

Fushëveprimi i shërbimeve

- Konsulenti/kompania e përzgjedhur do të jetë përgjegjës/e për: hartimin e kornizës së M&V për Arsimin Dual;
- zhvillimin e mjeteve të standardizuara të monitorimit dhe raportimit;
- mbështetjen në përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të M&V brenda OEK-së;
- realizimin e punëtorive për ngritje të kapaciteteve për stafin e OEK-së;
- mbështetjen në analizën e të dhënave dhe përgatitjen e raporteve analitike.

Rezultatet e pritshme

Angazhimi duhet të rezultojë me:

- Kornizë gjithëpërfshirëse të M&V-së;
- Matricë indikatorësh dhe metodologji raportimi;
- Modele të standardizuara për monitorim dhe raportim;
- Udhëzues dhe mjete përdorimi;
- Rrjedha të brendshme koordinuese për M&V;
- Punëtori për ngritje kapacitetesh të realizuara;
- Raport analitik të M&V me rekomandime.

Kohëzgjatja e angazhimit

Angazhimi pritet të zbatohet brenda një periudhe prej afërsisht **tre (3) muajsh** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Kriteret e kualifikimit

Konsulentët/kompanitë e interesuara duhet të dëshmojnë:

- minimumi 5 vite përvojë në Monitorim dhe Vlerësim;
- përvojë të dëshmuar në projekte zhvillimore, preferohet në arsim, Arsim dhe Aftësim profesional, treg të punës ose zhvillim të sektorit privat;
- përvojë në hartimin e sistemeve dhe mjeteve të M&V;
- përvojë në facilitimin e punëtorive dhe trajnimeve;
- aftësi të forta analitike dhe raportuese.

Njohja e sistemit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional në Kosovë konsiderohet përparësi.

Dokumentet për Aplikim

- Aplikuesit e interesuar duhet të dorëzojnë:
- Propozim teknik;
- Propozim financiar;
- Profilin e kompanisë dhe/ose CV-të e ekspertëve;
- Dëshmi të përvojës relevante dhe referenca;
- Kopje të certifikatave të regjistrimit (për kompanitë).

Afati për Dorëzim

Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht jo më vonë se 30 maj 2026 në arsimidual@oek-kcc.org me subjektin:

“Aplikim – Shërbime Konsulence për Kornizën e M&V për Arsim Dual”

Aplikimet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në konsideratë.

Informata Shtesë

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për vlerësim të mëtejshëm.

Termet e Referencës (ToR) mund të ndahen sipas kërkesës tuaj përmes kontaktit me: arsimidual@oek-kcc.org.

Lulzim Rafuna

Kryetar

Oda Ekonomike e Kosovës



